



SOFTUERI

www.shmk-negotine.edu.mk

NDARJA E SOFTUERIT

Softveri nuk mund të punojë pa harduer, sikurse as hardueri nuk mund të punojë pa softuer.

Softueri zakonisht gjendet te Harddisku prej ku lexohen të dhënat në Ram memorje, por prej këtu percillet tek procesori i cili kryen urdhera prej ndonjë programi.

Softueri mund të ndahet në dy grupe:

- 1) Softuer SISTEMOR;
- 2) Softuer APLIKATIV (konsumator).

SOFTUERI SISTEMOR

Softueri sistemor eshte i domosdoshem per pune te kompjuterit. Ai gjithmone eshte present te kompjuteri dhe mundeson shfrytezimin e tij me te lehte, me te thjeshte dhe me efikas.

Programet sistemore ndahen ne:

- 1) Sistem Operativ (OS – Operating System);
- 2) Programe sherbyese (utility);
- 3) Programe drejtuese (kontrolluese) dhe softuer komunikativ;
- 4) Sistem programor.

SISTEMI OPERATIV

Sistemi operativ (SO) është bashkësi prej programeve të cilat e **kontrollojnë dhe e koordinojnë punën e njësive harduerike** dhe mundësojnë kryerje të programeve të konsumatoreve. SO pranon urdhera nga konsumatori dhe mundëson kryerjen e tyre.

SO zbatohet si ndërmjetësues midis konsumatorit dhe programeve të harduerit.

Kompjuteret e sotëm personal shfrytëzojnë: Windows 95, Windows 98, Windows Millennium, Windows 2000, Windows Xp, Windows Vista, Windows 7, Windows 8 dhe Windows 9.

Ndërsa kemi edhe sisteme tjera operative: Linux, Unix, Mac OS X.

PROGRAMET SHERBYESE

Programet sherbyese konsumatorit i mundesojne udheheqje me te dhenat dhe me komponentet harduerike.

Ata kryejne pune sikurse eshte: **formatimi, pastrimi dhe mbajtja e harddiskut, klasifikimi, kopjimi dhe bartja e datotekave, organizimi dhe gjetja e te dhenave, kompresioni i te dhenave, instalimi i softuerit, mbrojtja prej viruseve etj.**

Keto programe shpesh jane ndertuar ne sistemin operativ, por disa prej tyre prodhohen dhe shiten ne vecanti.

PROGRAMET UDHEHEQESE DHE SOFTUER KOMUNIKUES

Programet udheheqese kujdesen qe instruksionet programore te barten deri te njesite harduerike perkatese dhe te kryejne (psh, **urdher per shtypje**).

Programet komunikuese mundesojne komunikim ndermjet kompjutereve.

SISTEMI PROGRAMOR

Sistemin programor e perbejne programet te cilat u ndihmojne programoreve si mbeshtetje ne perpunimin e softuerit. Para se gjithash, ata jane **editore** te te cilat **shkruhen** programe dhe perkthyes programor (compilers) te cilat urdherat e shkruara prej ndonjerit prej gjuheve programore i shnderojne ne kode binare te kuptueshem per procesorin.

SOFTUER APLIKATIV

Softuerin aplikativ e perbejne programe te cilat mundesojne qe kompjuteri te kryeje detyra konkrete per nevojat e konsumatorit. Dmth ato jane programe te dedikuar per konsumatore dhe quhen Softuer i dobishem. Mund te jete softuer biznesi, edukativ, softuer per pune ne zyre etj.

Te programet aplikative bejne pjese:

- **perpunimi i teskitit** (Notepad, Wordpad, Word, Writer, Quark Xpress, Indesign etj)
- **perpunimi me tabela** (Excel, Cals, Lotus etj)
- **perpunimi i fotografive dhe vizatimeve** (Paint, Photoshop, CorelDraw, Illustrator etj)
- **perpunimi me baze te te dhenave** (Access, Fox Pro, Oracle etj)
- **perpunimi i prezantimeve** (PowerPoint, Impress, FrontPage, Flash, Dreamweaver etj)
- **perpunimi i zerit dhe video shenimeve – multimedia** (Windows Media Center, Power DVD, BS Player Pro, Winamp etj)
- **njesime ne shkence, ne teknike dhe ne statike** (Mathematica etj)
- **puna me internet** (Internet Explorer, Firefox, Google Chrome, Opera etj)
- **lojera** (ku bejne pjese te gjitha lojerat)
- si dhe shume te tjera.

PYETJE

